



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE MARRËDHËNIEVE ME  
PUBLIKUN

Nr. 126 prot.

Tiranë, më 22. 1. 2021

**URDHËR**

Nr. 17, datë 22. 1. 2021

**PËR**

**MARRJEN E MASAVE DHE MONITORIMIN E VEPRIMTARISË, SJELLJES  
APO PËRDORIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE  
LOGJISTIKE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË PROCESIT  
ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, PËR VITIN  
2021**

Në mbështetje të Nenit 13, pika a, të Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, si dhe të Urdhrit nr. 9265, datë 31.12.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,

**URDHËROJ**

1. Vënie në dispozicion dhe njohjen nga ana e gjithë stafit të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
2. Raportimi në ndërfaqen e KQZ të realizohet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit në komunikim të ngushtë me Drejtorin Ekzekutiv dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose të aktivitetit publik.
3. Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive/Koordinatorit, është përgjegjëse për:

- kontrollin në mënyrë periodike të veprimtarisë së nëpunësve dhe punonjësve të AAC-së, me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
  - publikimin e të dhënave të kontaktit në faqen zyrtare përkatëse të internetit, duke kërkuar denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes, apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të AAC-së në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
  - verifikimin dhe analizimin e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale.
  - verifikimin që automjetet dhe karburanti të ndalohen të përdoren për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje.
  - njoftimin e stafit për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore.
  - marrjen e masave dhe realizimin e monitorimit të zbatimit të parashikimeve ligjore për të garantuar:
    - i. Mospërdorimin e burimeve njerëzore të AAC-së në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore dhe subjekteve zgjedhore, në zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
    - ii. Mospërdorimin e fondeve të AAC-së për veprimtarinë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore.
    - iii. Mospërdorimin e mjeteve dhe materialeve në inventar të AAC-së për veprimtarinë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore.
    - iv. Moslejimin e veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore.
    - v. Moslejimin në fushatë zgjedhore të pjesëmarrjes së administratës së AAC-së brenda ose jashtë orarit zyrtar.
4. Ngarkohet gjithë stafi i AAC-së për zbatimin e këtij Urdhri deri në datë 25 Prill 2021.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Edlira Kraja**

